

Flamur Kabashi

Dritë

në kohën tonë



Flamur Kabashi

Dritë në kohën tonë

Mitrovicë, 2016

Flamur Kabashi

Dritë në kohën tonë

Mitrovicë, 2016

Redaktor gjuhësor: **Imer Pantina**

Ballina dhe faqosja: **Afrim Radoniqi**

Boton: **Vi Print - Mitrovicë, Kosovë**

Viti: **2016**

Tirazhi: **1000 copë**

Përmbajtja:

Parathënia.....	7
Besimi shtohet dhe pakësohet	9
Kur'ani, leximi, dituria dhe ambicia e lartë	12
Bamirësia	23
Daveti.....	31
Edukata e lartë.....	43
Namazi nafile	51

بسم الله الرحمن الرحيم

Parathënia

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar i cili e bëri të qartë rrugën e drejtë, e zbriti Kur'anin, e dërgoi Muhamedin ﷺ sqarues të tij, e bëri fenë të lehtë, e komplotoi dhe e ruajti atë prej ndryshimeve. Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Tij dhe dëshmoj se Muhamedi ﷺ është rob dhe i dërguar i Tij.

Padyshim se gjëja më e rëndësishme në jetën e besimtarit është që ta fitojë kënaqësinë e Allahut të Madhëruar. Mirëpo, për shkak të preokupimeve të shumta ditore dhe jetës dinamike në këtë kohë, pastaj shtimit të mëkateve, dobësimit të adhurimeve, rënies së ambicieve etj, ndodh që besimtari të largohet nga rruga e cila e shpie tek kjo kënaqësi, ashtu që besimi i tij vetëm se bie çdo ditë e më shumë. Andaj edhe po mundohem që me lejen e Allahut të Madhëruar t'i përshkruaj disa prej rasteve të burrave të mëdhenj të

kësaj kohe, të kohës së teknologjisë dhe të sprovave, në mënyrë që ta shtojmë besimin, t'i ngjallim ambiciet dhe ta rrisim performancën e lëvizjes sonë drejtë Kënaqësisë së Allahut dhe Xhenetit të Tij, duke e lutur Atë që të na dhuroj sinqeritet në vepra e në fjalë dhe të na mundësoj të përfitojmë prej këtyre fjalëve.

Kapitulli 1

Besimi shtohet dhe pakësohet

Para se të filloj të i ceki shembujt e ndritur prej jetës së burrave të mëdhenj, gjithnjë në përpjekje për të shtuar besimin dhe rritur ambiciet tona, dëshiroj të përmendi se besimi (imani) shtohet me vepra të mira dhe zvogëlohet me vepra të këqija, që do të thotë se nuk është një gjë konstante. Andaj, këtu po përmendi shkurtimisht disa prej argumenteve shariatike.

Allahu i Madhëruar thotë:

...e atyre që besuan t'u shtohet edhe më besimi.¹

...dhe nuk u shtoi përveç se besimin dhe nënshtrueshmërinë.²

¹ Kur'ani, Mudethir: 31.

² Kur'ani, Teube: 124.

...dhe kur u lexohen atyre ajetet e Tij ua shton atyre besimin.³

I Dërguari i Allahut të Madhërishëm ﷺ në një hadith thotë:

Kush e sheh prej jush një të keqe le ta ndryshojë me dorën e tij, e nëse nuk mundet, atëherë me gjuhën e tij, e nëse nuk mundet, atëherë me zemrën e tij, e ky është besimi më i dobët.⁴

Po ashtu transmetimet e sahabëve për çështjen e shtimit dhe pakësimit të besimit janë të shumta, prej tyre po citojmë:

Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, shokëve të tij u thoshte:

Ejani ta shtojmë besimin.⁵

³ Kur'ani, Enfal: 2.

⁴ Shënon Muslimi, nr. 49.

⁵ Sherh usul itikad ehli suneh, nr. 1700.

Abullah ibn Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me të, thoshte:

*O Allah na e shto besimin, bindjen dhe kuptimin në fe.*⁶

Po ashtu transmetohet prej Ibn Abasit, Ebu Hurejrës dhe Ebu Derdas, Allahu qoftë i kënaqur me ta, se thonin:

*Besimi shtohet dhe pakësohet.*⁷

E njehta gjë transmetohet edhe prej dijetarëve të shekullit të dytë, të tretë e kështu me radhë. Citatet e tyre janë të shumta, ndërsa këtu po përmendim vetëm thënien e Sufjan Theuriut dhe Veki' bin Xherrah, të cilët thonin:

*Besimi shtohet dhe pakësohet.*⁸

⁶ Sherh usul itikad ehli suneh, nr. 1704

⁷ Sherh usul itikad ehli suneh, nr. 1709, nr. 17111, 1712.

⁸ El-Ibaneh, nr. 1143, 1144.

Kapitulli 2

Kur'ani, leximi, dituria dhe ambicia e lartë

Po filloj me atë me të cilën e filloi Allahu i Madhëruar shpalljen, pra me fjalën: **“Ikra”** (Lexo), dhe se në këto pesë ajetet e para të zbritura fjala "lexo" përmendet dy herë, pastaj fjala "laps" një herë, e po ashtu fjala "mësoi" dy herë, fjalë të cilat janë burim i diturisë dhe ngritjes së vetëdijes tek njerëzit. Prej këtu kuptojmë se muslimanët duhet të mburren kur të përmendet dituria për shkak se ne jemi popull i leximit.

Në vijim do të përmendi raste të ndritura nga jeta e dijetarëve të mëdhenj të kohës bashkëkohore, ashtu që të shohim lidhjen e tyre me leximin apo diturinë.

Shejh Muhamed Nasirudin Albani ⁹

Është pyetur shejh Albani për suksesin e bashkimit mes kërkimit të diturisë dhe punës që bënte si orëndreçës, e ai u përgjigj:

Është e vërtetë se kjo është prej dhuntive të Allahut dhe të mirave të Tij, i cili më udhëzoi drejt këtij zanati, sepse ajo nuk më ndërhynte në punën time rreth hadithit. Zanatit ia kushtova vetëm tri orë në ditë, përveq të martës dhe të premtes e që më mjaftonin sa për të fituar furnizimin e mjaftueshëm për familjen dhe fëmijët e mi.

Prej lutjeve të Dërguarit ﷺ ishte: O Allah bëje furnizimin e familjes së Muhamedit "kut", ushqim të mjaftueshëm. Këtë e shënojnë Buhariu dhe Muslimi, dhe se tërë kohën tjetër e kalova në kërkim të diturisë, në shkrime dhe studim të librave të hadithit, e sidomos

⁹ Dijetar dhe muhadith i njohur i këtij shekulli. U lind në vitin 1914 në qytetin e Shkodrës dhe vdiq në vitin 1999 në Aman.

dorëshrimet e librarisë Dhahirijeh, andaj unë qëndroja në të sikurse punëtorët e saj. Koha të cilën e kaloja aty ishte prej gjashtë deri në tetë orë në ditë varësishtë prej orarit veror apo dimëror me të cilin punohej aty.¹⁰

Tragon dr. Mahmud el-Mirah se shejh Naseri (Albani):

Është ngjitur mbi shkallë të librarisë Dhahirijeh për të mbërri një libër. Pasi e mori, e hapi atë dhe mbeti aty mbi shkallë mbi gjashtë orë duke e lexuar atë.¹¹

Shejh Safijurrahman Mubarekfuri ¹²

Pasi u shpall gara e njohur për studime shkencore fetare nga ana e Lidhjes së Botës Islame me qendër në Meke (Rabiat el-alem el-islami), me temën: "*Historia Pejgamberike*", në vitin 1976, e shkruajti

¹⁰ Abdulaziz es-Sed-han, *El-Imam el-Albani*, f. 25.

¹¹ Aty, f. 63.

¹² U lind në vitin 1943 në Mubarekfur, në Indi dhe vdiq në vitin 2006.

librin e tij të njohur "*Nektari i vulosur i xhennetit*" e dorëzoi aty pranë komisionit dhe e fitoi vendin e parë.¹³ Ajo që duhet theksuar është se ky njeri nuk ka mësuar në botën arabe asnjë ditë (para se ta shkruante librin), pastaj, aty në garë numri i studimeve të dorëzuara prej gjithë botës islame ishte 171, prej tyre 84 studime apo libra në gjuhën arabe, prej autorëve arabë e joarabë dhe se ishin njerëz të njohur në fushën e studimeve islame; megjithatë ai me zellin e tij, me studim të thellë, me ambicie të larta, ua kaloi të gjithëve ku edhe më pas ky libër u bë libri më i njohur i cili flet për jetën e të Dërguarit të Allahut të Madhëruar ﷺ në këto dekadat e fundit në tërë botën islame.

Shejh Muhamed el-Emin esh-Shenkiti

Një dijetar i madh nga Mauritania, në moshën 42 vjeçare ishte nisur për ta kryer haxhin, por Allahu deshi që ky njeri të ndalet në Medine dhe që më pas

¹³ www.ar.islamway.net, Artikull nga: Tarik bin Safijurrahman Mubarekfuli, Shejh Safijurrahman Mubarekfuli.

të bëhet njëri prej dijetarëve më të dalluar në Arabinë Saudite, sidomos në shkencën e tefsirit.

Të ndalemi pak tek tregimi i shejh Uthejminut i cili e tregon takimin e parë të tij me këtë dijetar të madh duke thënë:

Ishim nxënës në shkollën e mesme fetare në Rijad; aty në klasë e prisnim se kush do na vijë të na mësojë lëndën e tefsirit, kur ja një i vjetër hyri tek ne, me dukje dhe rroba të vjetra e të grisura, sikur të ishte "beduin" (njeri shkretëtire e i pagdhendur), atëherë thash në vete: ky nuk ka dituri, si e braktisa mësuesin tim Abdurrahman Sadin (dijetarin e tefsirit) në Unejzeh e të humbi kohë pranë këtij beduini.

Menjëherë sa filloi shejh Shenkiti¹⁴ ligjeratën në tefsir; sjelli dobi mahnitëse dhe dituri të thella nga fjala e Allahut, me argumente dhe shembuj gjuhësor, nga një det i

¹⁴ Muhamed el-Emin esh-Shenkiti u lind në vitin 1907 dhe vdiq në vitin 1973.

*mrekullueshëm. Këtu kuptova se ne ishim pranë një dijetari gjigant, gjeni prej gjenive të dijes, prej të cilit përfituam diturinë, qëndrimin, edukatën, asketizmin...*¹⁵

*Ambiciet e tij ishin të larta, ai thoshte: Çdo ajet (citat) të Kuranit Famëlartë e kam studiuar veç e veç.*¹⁶

Shejh Abdulkadir Arnauti

Ky dijetar tregonte për ambiciet që kishte si i ri. Ai edhe pushimin e bënte lexim. Kështu, ai thoshte:

Gjatë pushimit mes orëve mësimore, mësoja nga pesë hadithe përmendësh; kisha një kujtesë të mirë dhe memorizim të fortë, me falënderim ndaj Allahut dhe ndihmën e Tij.

¹⁵ www.alukah.net, Ali esh-Shinkiti, *Biografia e shejh Muhamed el-Emin esh-Shinkiti*.

¹⁶ Edva el-bejan, v1, f. 23.

Shejh Muhamed Shakiri

Prej elementeve shumë me rëndësi në formimin e personalitetit intelektual është rrethi i mirëfilltë familjar, prej të cilit ushqehen brezat dhe ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këtu po e përmendi rastin e Muhamed Shakirit¹⁷ i cili djemve të tij u lexoi tefsirin dy herë, tefsirin e Begaviut dhe tefsirin e Nesefiut, pastaj u lexoi atyre edhe Sahihun e Muslimit dhe Sunenin e Tirmidhiut me Shemail, (po ashtu edhe libra të ndryshme në Fikh dhe Usul fikh). Por kjo punë nuk shkoi huq pasi që prej shtëpisë së tij dolën dy dijetarë të mëdhenj: Ahmed dhe Mahmud Shakir, i pari i njohur në lëminë e hadithit dhe lëmi tjera, ndërsa i dyti në lëminë e gjuhës dhe poezisë arabe.

¹⁷ Është dijetar i njohur i Universitetit të Ez-Herit.

Shejh Ali Tantavi

Dijetari dhe shkrimtari i njohur sirian Ali Tantavi¹⁸ në librin e tij: *"Kujtimet e Ali Tantavit"* thotë:

Unë sot dhe unë dje, edhe si i ri, kohën më të gjatë e kaloj në "Shtëpinë lexo". Ndodh që ndonjë ditë të lexoj treqind faqe, porse mesatarja e leximit gjatë ditës është njëqind faqe; kjo prej vitit 1340 h deri më 1402 h (1921 - 1981).

Shejh Hamud et-Tuvejxhri

Njëri ndër mësuesit më të afërt të shejh Hamud et-Tuvejxhrit ishte Abdullah bin Abdulaziz el-Ankari, gjykatësi suprem i qytetit el-Mexhmea'h, pranë të cilit qëndroi për njëzet e pesë vite me radhë dhe me të lexoi shumë libra, ku prej tyre ishte: *el-Mugni*

¹⁸ U lind në Damask në vitin 1909 dhe vdiq në vitin 1999 në Arabinë Saudite.

(enciklopedi e fikhut), Fet-hul-bari, Fetava shejhul-islam Ibn Tejmije etj.¹⁹

Shejh Abdullah bin Xhibrin

Tregon dr. Abdurrahman bin Abdullah el-Xhibrin për babain e tij shejh Abdullah bin Xhibrin²⁰ se si ishte përvoja e tij me memorizimin e Kur'anit duke thënë:

Babai kishte shprehur dëshirë të mësonte pranë një dijetari i cili quhej Abdulaziz esh-Shethri, mirëpo ai i kishte thënë: së pari mësoje (memorizojë) Kur'anin e pastaj eja dhe mëso tek unë.

Babai thoshte: unë më herët kisha memorizuar dymbëdhjetë pjesë (xhuza) të Kur'anit e u ndala këtu, për arsye se nuk kishte kush të na

¹⁹ Abduaziz es-Sed-han, nga libri për jetën e shejh Hamud et-Tuvejxhri, f. 14-24.

²⁰ U lind në vitin 1352 h në një vend i cili quhej Kuveijeh, në mes të Arabisë Saudite . Ishte prej dijetarëve të dalluar të Arabisë Saudite. Vdiq në vitin 1430 në Rijad (1933-2009).

motivonte për mësim apo memorizim të Kur'anit.

Pasi i dëgjoi këto fjalë nga shejh Abdulaziz esh-Shethrit, thotë: U mbylla në xhami deri sa e mbarova memorizimin e plotë të Kur'anit brenda tetë muajve. Qëndroja prej pas namazit të sabahut e deri afër drekës, lexoja nga dhjetë pjesë (xhuza), përsëritja dhe memorizojta afërsisht gjysmë pjese (xhuzi) rreth dhjetë faqe, pastaj dilja për të ngrënë bukë dhe prapë kthehesha dhe vazhdoja mësimin.

Po ashtu dr. Abdurrahmani për babain e tij thotë:

Libri ishte shoku i tij, nuk e shihje kurrë pa libër në dorë, sa që kur shkonim prej Rijadit në Meke, rruga zgjaste afërsisht dhjetë orë udhëtim. Tërë kohën e kishte librin pranë veti dhe lexonte.²¹

²¹ Marrë nga një dokumentar për jetën e shejh Abdullah bin-Xhibrinit, nga djali i tij Abdurrahman bin Abdullah el-Xhibrin.

Shejh Shuajb Arnauti ²²

Tregon se si i ri shiste oriz, sheqer etj, ndërsa në anën tjetër mësonte tek dijetarët e Damaskut. Një herë i tha një mësuesi të xhamisë Beni Umejeh:

Babai im më ndalon mua të vij në xhami prej pas akshamit e deri në jaci, mirëpo unë do e fali jacinë në xhaminë Beni Umejeh, ndërsa ti banon në lagjen Imerijeh, andaj do të përcjelli ty ashtu që gjatë rrugës për në shtëpinë tënde të më mësosh një mësim të gjuhës arabe. Kështu vazhdova të mësoj me të për shtatë apo tetë muaj me radhë, për çdo ditë nga një mësim.²³

²² Dijetar i njohur i hadithit dhe recenzues i qindar librave dhe dorëshkrimeve të vjetra . U lind në vitin 1928 në Damask dhe vdiq në vitin 2016 në Aman.

²³ Dr. Shuajb Arnauti, *Fletë nga jeta ime*, Dokumentar.

Kapitulli 3

Bamirësia

Bamirësia është prej cilësive të burrave të mëdhenj, cilësi e të gjithë të Dërguarve të Allahut, përmes së cilës muslimani ka mundësi të fitoj në të dy botët; në këtë botë fiton jetë të mirë, të begatshme, qetësi shpirtërore e kështu me radhë, ndërsa në botën tjetër shpërblimin e Allahut të Madhëruar, lehtësim të peripecive të Ahiretit e deri te shpërblimi me Xhenet.

Më poshtë po japim shembuj të përzgjedhur të cilët shërbejnë si shëmbëlltyrë e këtij virtyti kaq të lartë siç është bamirësia.

Shejh Albani

Tregon Muhamed el-Hatib i cili punonte në shtëpinë e shejh Albanit duke thënë:

Sa herë që e nxitja shejhun për të ndërtuar ndonjë xhami apo t'i ndihmoj ndonjë të varfëri, të veje ose lypësi, ai nuk më refuzonte.²⁴

Shejh Abdulaziz bin Baz ²⁵

Tregon Muhamed el-Musa për shejh Bin Bazin:

Tri vite para se të vdiste një njeri i mori borxh 700 mijë rijal. Më vonë i shkroi atij borxhliu se boxhin e ka të falur. Atëherë unë i thash: Allahu i shtoftë të mirat e kësaj llogarie bankare, llogarisë personale të shejhut, ndërsa ai ma ktheu: O biri im, mos u merr me këtë botë, unë i mbusha 87 vjet dhe nuk kam parë prej Zotit tim përveç se të mira. Kjo botë vjen dhe shkon, kurse dallimi i atij që vdes dhe ka lënë 100 milion dhe atij që vdes e nuk ka lënë asgjë është se i pari e ka llogarinë shumë të

²⁴ Abdulaziz es-Sed-han, *El Imam el-Albani*, f.68

²⁵ Dijetar i njohur dhe myfti i Arabisë Saudite. U lind në vitin 1330 h në Rijad dhe vdiq në vitin 1420 h (1912-1999).

rëndë në ditën e gjykimit, ndërsa i dyti të kundërtën.²⁶

Shejh Muhamed el-Emin es-Shenkiti

Nuk e mbante rrogën e tij përveç aq sa i nevojitej për një muaj. Pjesën tjetër ua jepte studentëve të varfër, të dobtëve dhe të vejave brenda familjes së tij. Andaj edhe thoshte:

Kam ardhur prej një vendi prej të cilit mora një gjë që pak njerëz e kanë, të mjaftuarit me pak.²⁷

Shejh Salih el-Husejn

Me dy vëllezërit e tij Sadin dhe Abdullahun e kishin një llogari bankare të përbashkët. Shpenzonin prej saj dhe jepnin lëmoshë dhe se nuk ndalnin prej saj më tepër se nevojat elementare. Sadi thoshte:

²⁶ Muhamed El-Hamed, *Teraxhum*, f. 421.

²⁷ Edva el-bejan, v1, f. 31.

Nuk mbaj në mend se ne e kemi nxjerr zekatin, sepse e tërë ajo që ishte e tepërt ua japnim meritoreve para se të vinte afati i zekatit, kështu vëllau ynë Salihu na e mori fjalën se nuk do ruajmë më shumë se nevojat tona, andaj edhe e mbajtëm atë. Në këtë mënyrë e patëm vetëm një llogari.²⁸

Shejh Abdulkadir Arnauti

Ejmen bin Ahmed Dhul-gina duke folur për shejh Abdulkadir Arnautin thotë:

Më kujtohet gjatë kohës së studimeve. E vizitova me disa shokë të verbër. Pash se si i mëshiroi ata, i motivonte të kërkojnë dituri dhe të vazhdojnë me studime. I ngushëllonte edhe për sprovën që i kishte goditur, u citonte hadithe të cilat flasin për vlerën e durimit dhe humbjes së shikimit dhe shpërblimin në Ditën e

²⁸ www.al-jazirah.com, Muhamed El-Furejh, Shkrim mbi biografinë e shejh Salih-El-Husejn.

Gjykimit të cilin ua ka përgatitur Allahu durimtarëve. Shejhu nuk u mjaftua me kaq, por i kapi ata për duar dhe hyri në dhomën e afërt, pastaj dolën prej saj. Kur dolëm prej shtëpisë së shejhut koptova se u kishte dhënë një shumë të hollash që t'i gëzonte dhe t'u ndihmonte atyre.²⁹

Shejh Abduaziz el-Vehejbi

Një kërkues diturie nga Jemeni me emrin Marish el-Amiri, kur erdhi në qytetin Rijad të Arabisë Saudite, kishte dëgjuar për një shejh i cili quhej Abduaziz el-Vehejbi.³⁰ Shejh Mukbil el-Vadi'i e kishte porositur që ta takonte atë, sepse ai (shejh Abduazizi) bashkoi mes diturisë, thirrjes dhe ndërmjetësimit.

²⁹ Ejmen Bin Ahmed Dhul-Gina, Shkrim mbi jetën e shejh Abdulhadir Anautit.

³⁰ Shejh Abdulaziz-el-Vehejbi u lind në vitin 1384 h afër qytetit Shekra, diku 150 km larg Rijadit dhe vdiq në vitin 1430 h në një aksident rrugës Rijad-Damam (1964-2009).

Ai tregon:

E kishte kontaktuar shejh Abduaziz el-Vehejbin përmes telefonit dhe se kishte kërkuar prej tij që ta takonte. Shejh Abduazizi i tha atij: *Eja të hash iftar me mua për aksham*, pasi ishte fundi i Ramazanit, ndërsa unë ia ktheva: *Ndoshta nuk do të mundem të vij pasi që jam larg, po ashtu nuk kam edhe mjet transporti*. Ai ma ktheu: *Nëse nuk vjen të hash iftar, mos eja fare!* Atëherë i thash: *Do të vij inshaAllah*.

Pasi ma tregoi rrugën e mbylla telefonin. E mora një taksì dhe u nisa në drejtim të tij. Kur arrita tek vendi ku ishte ai, e takova te një bankomat afër shtëpisë së tij. E përshëndeta me selam, u njoftova me të duke i thënë: Vëllau yt Marish që të kontaktova ma herët. Më priti me një pritje shumë të ngrohë sikur të më kishte njohur më herët dhe se nuk më ka parë kohë të gjatë, pastaj m'i dha një mijë rijal (rreth 200 euro) dhe tha: *Shko paguaje taksin*. I thash: *Unë e kam paguar,-*

mirëpo ai ma ktheu: *Atëherë, futi në gjep, sepse ajo që del prej gjepit nuk kthehet brenda.*³¹

Shejh Umer el-Eshkar

Dr. Usameh Ebu Bekr tregon për bëmirësinë e mësuesit të tij shejh Umer el-Eshkar³² duke thënë:

Sa i përket dhënies ishte shkollë në këtë pikë. Nuk ka ndodh që t'i flas për ta ndihmuar dikë e të më refuzonte. Një herë i fola për një person që fal namaz, nevojat e të cilit e kishin shtyer të merrte borxh me kamatë nga një bankë, por ishte penduar maksimalisht. Tani po e joshin me banesën e tij që t'ia tërheqin ato paratë e kamatës. Shejhu u mërzit për këtë, më pyeti: Sa është shuma? I thashë: 8000 dinar (Jordanez).

³¹ Marrë nga libri biografik mbi shejh Abdulaziz el-Vehajbi të autorit Halil Bin Ibrahim Emin.

³² Shejh Umer el-Eshkar është autor i shumë librave nga fusha të ndryshme fetare. U dallua me shkrimet e tij në lëminë e akides. U lind në vitin 1359 h dhe vdiq në vitin 1443 h (1940-2012 sipas kalendarit gregorian).

Menjëherë më tha: Unë do t'i japi 6000, e ai le të shikon për dy mijë tjera, mirëpo me kusht që ti të shkosh me të dhe t'ia paguash këtë pjesë. Për Zotin u çudita me këtë reagim të shpejt të tij.³³

³³ www.ashqar.net, shkrim nga dr. Usameh Ebu Bekr me disa përjetimet e tij me shejh Umer el-Eshkar.

Kapitulli 4

Daveti

Thirrja islame apo daveti është prej adhurimeve më të vlershme. Ishte prej detyrave kryesore të të Dërguarve të Allahut të Madhëruar, përmes së cilës u sqarohej njerëzve rruga e drejtë e u mësohej atyre Islami.

Allahu i Madhëruar thotë:

E kush flet më mirë se ai i cili thërret në rrugën e Allahut, bënë vepra të mira dhe thotë unë jam prej muslimanëve. ³⁴

I Dërguari i Allahut të Madhëruar ﷺ i tha Aliut, Allahu qoftë i kënaqur me të: Për Zotin, nëse Allahu e udhëzon një njeri në dorën tënde, është më mirë për ty se devet e kuqe. ³⁵

³⁴ Kur'an, Fusilet: 33.

³⁵ Buhariu, nr. 2942 dhe Muslimi nr. 2406.

Shejh bin Bazi

Qëndronte me njerëzit pas namazit të akshamit (çdo ditë) përveç kur kishte ligjëratë. Ditën e enjte qëndronte prej orës njëmbëdhjetë e deri në namazin e ikindisë, ndërsa ditën e premte prej pas namazit të xhumasë deri në namzin e ikindisë. Po ashtu, ditëve të punës pasi e hante drekën, qëndronte deri në ikindi nëse premtonte koha. Këto ishin ndejat e tij me njerëzit në përgjithësi.

Në këto ndeja vinin njerëz të ndryshëm, dijetarë, zyrtar që vinin ta vizitonin atë; ndonjë tjetër për ta përshëndetur, ndonjë i afërm i tij apo edhe dikush për ta pyetur, apo për ta zgjidhur ndonjë problem.³⁶

³⁶ Muhamed El-Hamed, *Teraxhum*, f. 409.

Shejh Abdulhamid bin Badis ³⁷

Ishte njeri me abicie të larta. Qysh si fëmijë e mësoi Kur'anin përmendësh. Mbaroi studimet në Universitetin e Zejtunes në Tunis, pastaj shkoi në Meke për ta bërë Haxhin, e më pas u ndal në Medine ku edhe qëndroi tre muaj rresht. Aty u njoftua me disa dijetar dhe njëri prej tyre ishte Muhamed el-Beshir el-Ibrahimi me të cilin ulej netëve të këtyre tre muajve. Gjatë kësaj kohe bën planin dhe mjetet për ta ngritur Algjerin. Pasi u kthye në vendlindje në vitin 1914 filloi me aktivitete të ngjeshura ku gjatë tërë ditës i mësonte nxënësit, mbante ligjërata në lëminë e tefsirit, hadithit. Po ashtu rëndësi i kushtonte këshillave dhe edukimit të popullit në përgjithësi. Këtë e bënte në disa xhami të qytetit, e më pas ai u zgjerua shumë, sa hapi qendra të ndryshme, shkolla, revista, etj. Tërë kjo për ta

³⁷ U lind në vitin 1889 në qytetin Kosantinah, në veri të Algjerisë dhe vdiq në vitin 1940.

edukuar popullin algjerian në frymën islame dhe të ngritet më tepër në aspektin edukativo-arsimor.³⁸

Shejh Abdurrahman es-Sumeji ³⁹

Me profesion ishte mjek, ndërsa më shumë se 25 vite i kaloi në thirrjen islame, në arsim dhe humanizëm mahnitës. Tërë këtë kohë e kaloi në kontinentin e Afrikës, duke i lënë të mirat e kësaj bote dhe duke kërkuar të mirat e Ahiretit. Sipas disa të dhënave, numri i personave që e kanë pranuar Islamin përmes tij është më i madh se njëmbëdhjetë milionë.⁴⁰

Po parafrazojmë disa prej thënieve të tij:

*E ndiej shijen e lumturisë atëherë kur e shoh
gishtin tregues kah qielli duke treguar
njëshmërinë e Zotit.*

³⁸ www.binbadis.net.

³⁹ U lind në vitin 1947 në Kuvajt dhe vdiq në vitin 2013.

⁴⁰ www.alukah.net, Abdulkërim es-Semek, Abdurrahman es-Sumeji, thirrësi për të cilin qajti Afrika.

Gjatë punës sime në Afrikë për më tepër se një çerek shekulli, gjëja që më së shumti ma gëzonte zemrën ishte kur e shihja ndonjë person duke e ngritur gishtin tregues lartë dhe e thoshte shehadetin.

Gjatë përvojës sime për më tepër se një çerek shekulli në Afrikë jam bindur se sjellja e mirë është mjeti më i mirë për daret.⁴¹

Shejh Muhamed bin Salih el-Uthejmin

Padyshim se ligjëratat e ndryshme fetare, pastaj përgjigjja ndaj pyetjeve të njerëzve janë prej mënyrave më efikase të daretit islam. Këtu po e përmendi rëndësinë që shejh Muhamed bin Salih el-Uthejmin⁴² u kushtone "fetvave" apo përgjigjjes së pyetjeve të njerëzve, përmes telefonit apo edhe drejtpërdrejtë. Shejh Umer el-Mukbil tregon se

⁴¹ www.twitter.com/dr_sumait.

⁴² Është njëri prej dijetarëve më të dalluar të botës islame. U lind në vitin 1928 në qytetin Unejzeh të Arabisë Saudite dhe vdiq në vitin 2000.

njëherë ishte i pranishëm në një ndej me shejh Uthejminin në shtëpinë e vëllait të tij në Rijad. Në këtë ndejë, Shejhu kishte takim me disa gjykatës; koha ishte pas ikindisë. Ata kërkuan prej tij që t'ua kushtonte atyre tërë këtë kohë, mirëpo të njejtën kohë Shejhu ua kishte lënë edhe atyre që thërrasin me telefon për të bërë pyetje.

Ai u tha gjykatësve:

*Nuk mundem, sepse këtë kohë ua kam kushtuar
njerëzve, por një pyetje keni ju, ndërsa një
pyetje telefonatat.⁴³*

Shejh Abdulkadir Arnauti

E hapte librarinë e tij çdo mbrëmje prej orës pesë e deri në orën shtatë. Aty vinin kërkues diturie prej vendeve të ndryshme, jo vetëm arabë, por edhe të

⁴³ www.almugbil.com, Umer el-Mukbil, Kam mësuar nga Ibn Uthejmini.

huaj nga sunitët e Iranit, prej Qeqenisë e Senegalit, po ashtu muslimanët e Amerikës e të Britanisë.

I shihje ata se si e respektonin atë, sikur të kishin zogj mbi kokat e tyre.⁴⁴

Shejh Salih el-Husejn

Prej gjërave shumë me rëndësi në fushën e davetit është edhe çështja se çdo vend dhe çdo kohë i kanë rrethanat e caktuara, andaj duhet pasur kujdes që ligjeratat dhe fetvatë të cilat janë folur në ndonjë vend apo në ndonjë kohë të caktuar, të mos barten në të gjitha vendet tjera. Dijetarët e çdo vendi janë ata të cilët i bëjnë këto gjëra. Shiko se si e kishte parasysh këtë gjë shejh Salih Husejni (përgjegjës i dy Haremeve) i cili nuk lejoi që ligjeratat dhe fetvatë e Haremit të përkthehen në gjuhë të huaja duke thënë:

⁴⁴ www.saaaid.net.

Jo çdo gjë që thuhet në ligjeratat apo fetvatë në Harem vlen për krejt muslimanët e botës. ⁴⁵

Shejh Muhamed Rashid Rida

Prej gjërave shumë me rëndësi në jetën e thirrësve Islam është shfrytëzimi i mjeteve bashkëkohore në mënyrë që kjo thirrje të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe të jetë sa më frytdhënëse në shoqëritë Islame. Një rast i veçantë i cili nuk duhet harruar është revista "*el-Menar*" të cilën e themeloi dijetari i njohur Muhamed Rashid Rida.⁴⁶ Në fillim ishte revistë javore. Pas disa viteve u bë revistë mujore. Kjo revistë (para më shumë se një shekulli) me gjithë vështirësitë e kohës, dobësimit të muslimanëve, përhapjes së injorancës në mesin e tyre, del si një zë i fuqishëm i thirrjes Islame, i përmirësimit dhe i vetëdijësimit të muslimanëve. Në këtë revistë botoheshin shkrimet e Muhamed Rashid Rida apo të Muhamed Abduh, në

⁴⁵ Muhamed El-Ahmeri, Sheh Salih El-Husejni, personaliteti dhe mendimi i tij.

⁴⁶ U lind në vitin 1865 dhe vdiq në vitin 1935.

lëminë e tefsirit. Revista përmbante edhe përgjigje (fetva) të ndryshme, shkrime fetare, shoqërore e historike, ligjërata të xhumasë etj. E tërë kjo kishte për qëllim përhapjen dhe përmirësimin e besimit të pastër Islam, po ashtu mbrojtjen e fesë dhe shkencave fetare apo edhe të shkencave të gjuhës arabe.⁴⁷

Shejh Abdullah bin Muhamed el-Karavi ⁴⁸

Si i ri në moshën katërmëdhjetë vjeçare shkoi në Sham për tregti, pastaj vazhdoi kështu rrugën e tregtisë duke i shëtitur shumë vende të ndryshme siç janë: Egjipti, Iraku, Turqia, Kuvajti, Bahrejni, Palestina deri në vitin 1345 h. Kjo shëtitje e tij në rrugën e tregtisë ishte përvojë e madhe për të, ku mësoi se si të sillet me njerëzit.

Në këtë vit vendosi të ndjek rrugën e diturisë dhe për këtë arsye shkoi në Indi ku qëndroi dhjetë muaj, mirëpo, sëmundja e rëndë e nënës së tij e detyroi të

⁴⁷ Halid en-Nexhar, Shkrim për jetën e Muhamed Rashid Rida.

⁴⁸ U lind në vitin 1315 h në Unejzeh dhe vdiq në vitin 1389 h (1897-1969).

kthehet në vendlindje. Pastaj në vitin 1355 h, prapë vazhdoi me rrugën e diturisë, me ç'rast shiti devet, delet si dhe pjesën e kopshtit të tij e u orientua kah dituria, për të filluar një epokë të re në jetën e tij, e cila do jetë përgatitje për rrugën e davetit.

Edhe këtë radhë shkoi në Indi ku qëndroi dy vite me plot zell dhe e kalonte tërë kohën në mësim. Pastaj shkoi në Katar e më pas në Rijad dhe në fund vendosi të shkoj në Haxh. Pas haxhit niset drejt jugut të Arabisë Saudite që ta kaloj kohën në thirrjen e pastër Islame, pasi kjo zonë ishte mbushur me shirk, me bestytini, me gjëra të ndaluara fetarisht, me njerëz falltor të cilët mirreshin me magji dhe kishte një lloj zbehje të madhe në dituritë fetare.

Pasi shkoi në jug, filloi me davet, e hapi një dyqan ku i mësonte të rinjtë e të vjetrit. Po ashtu i mësonte edhe në xhami. Shëtiti në shumë fshatra, mësoi dhe edukoi nxënës të ri, vazhdoi kështu larg familjes së tij për katër vite. Pastaj u kthye tek famija e tij në Unejze, mirëpo nuk qëndroi gjatë.

Pas dy muajsh përsëri u kthye në jug, ndërkohë kishte ndërtuar një shkollë. Pas dy viteve aty vijuan mësimin 130 nxënës, ndërsa mësues përveç tij ishin edhe disa nxënës të tij të dalluar. Përveç kësaj ndërtoi shumë xhami. Nuk u mjaftua me kaq, por numri i nxënësve dhe i shkollave u rrit aq shumë, sa që daveti i tij kaloi edhe në Jemen. Numri i shkollave të cilat i ndërtoi deri në vitin 1374 h ishte mbi 270.

Shejhu njihej si njeri me urtësi të madhe. Dinte të depërtonte në shoqëri dhe të bëhej më ndikues kur i thërriste njerëzit të përqafojnë fenë Islame në tërësi. Një herë shkoi tek një prijës i një fisi; dëshironte që daveti të fillonte prej shtëpisë së tij, pasi veç ishte njeri me pozitë. Gjatë takimit me të në shtëpinë e tij, shejhu filloi ta lavdëronte dhe ta nderonte, pastaj e pyeti: *A je ti prijësi i këtij fisi? Ai u përgjigj: Po, a je ti ai që njerëzit të lavdërojnë dhe flasin fjalë të mira për ty, e ne njerëz të tillë po kërkojmë, ashtu që të ndihmohet e mira, daveti e dituria.* Këtë njeri shejhu e bëri muezin edhe pse nuk falej, mirëpo

“Kujt i jepet urtësia, iu ka dhënë e mirë e shumtë”.⁴⁹

Pas kësaj ky njeri u përmirësua, u kap për fenë, sa që u bë imam i popullit të tij.⁵⁰

⁴⁹ Kur'an, Bekare: 269.

⁵⁰ Bendër bin Fehd el-Ida, Rruga e reformatorit Imam Abdullah bin Muhamed el-Karavi, f. 59-180.

Kapitulli 5

Edukata e lartë

Një prej faktorëve shumë të rëndësishëm në jetën e besimtarit është stolisja e tij me edukatë të lartë. Ai duhet të jetoj i edukuar ashtu siç ishin të Dërguarit e Allahut të Madhëruar dhe duhet ta kuptoj se edukata e lartë është adhurim me të cilin besimtari fiton shumë në këtë botë dhe në botën tjetër. Mjafton si nxitje për edukatë apo moral të mirë hadithi i të Dërguarit të Allahut ﷺ në të cilin thotë:

Më të mirët prej jush janë ata të cilët kanë moral (edukatë) më të mire.⁵¹

Kjo është një temë shumë e gjerë dhe rastet të cilat i ka shënuar historia islame janë të shumta, mirëpo do të mjaftohem me përmendje të disa rasteve të edukatës së disa dijetarëve bashkëkohor, qoftë ajo edukatë brenda shtëpisë me anëtarët e familjes,

⁵¹ Buhariu, nr.6035.

edukatë me dijetarët tjerë apo me njerëzit në përgjithësi.

Shejh Abdur-Rezak Afifi

Tregon Mahmud Abdur-Rezak Afifi ⁵² për babain e tij:

Ai nuk fliste fjalë të vrazhda ndaj nesh, siç bëjmë ne, mirëpo nëse hidhërohej në ne (fëmijët të tij) vetëm e godiste njërën shuplakë me tjetrën dhe thoshte me zë: La ilahe il-la Allah.⁵³

Shejh Salih el-Husejni

Shejh Sad el-Husejn për vëllain e tij Salih el-Husejnin thotë:

⁵² Abdur-Rezak Afifi u lind në vitin 1323 apo 1905 në një zonë prej zonave të Egjiptit e cila quhej el-Munufijeh dhe vdiq në vitin 1415 h apo 1994 në Rijad të Arabisë Saudite.

⁵³ Dokumentar: Sjellja e shejh Abdur-Resak Afifit me nxënësit e tij, 11.11.2008.

Prej se e mbaj në mend vëllain tim, nuk e kam dëgjuar duke e përmend dikë për të keq. Gjëja më e madhe që e ka thënë për ndonjë person i cili është sjellur keq me të është: Qenka me edukatë të falsifikuar.⁵⁴

Shejh Abdulkadir Arnauti

Nuk ua harronte njerëzve të mirën edhe nëse kanë gabuar ndaj tij. Ashtu që mësuesin e tij Muhamed Salih el-Furfur, i cili e kishte larguar prej mësimit vetëm se i lexonte librat e dijetarëve të mëdhej: Ibn Tejmijes dhe Ibn Kajimit. Gjithmonë e kujtonte për të mirë dhe lutej që Allahu ta mëshiroj e ta fal atë, ndërsa shpesh herë thoshte për të:

Prej shejh Salihut kam mësuar si ta kem frikë Allahun e Madhëruar.⁵⁵

⁵⁴ www.al-jazirah.com, Muhamed el-Furejh, Shkrim mbi biografinë e shejh Salih El-Husejn.

⁵⁵ Ejmen bin Ahmed Dhul-gina, Shkrim mbi jetën e shejh Abdulkadir Arnautit.

Shejh Muhamed Amër Abdul-latif

Shejh Ebu Is-hak el-Huvejni thotë për shejh Muhamed Amër Abdul-latin.⁵⁶

Ishte i madh në mendje dhe dituri, ndërsa zemrën e kishte sikur të fëmijëve (domethënë shumë modeste), nuk ia donte të keqen askujt.

Po ashtu për modestin e tij, nxënësi i tij shejh Tarik Ivedu-Llah thotë:

Vinte në disa ligjërata të mia dhe i dëgjonte ato (ndërsa shejh Muhamed Amër Abdul-Latif ishte mësuesi i tij).⁵⁷

⁵⁶ Shejh Muhamed Amër Abdul-latif është dijetar i madh i hadithit. U lind në vitin 1374 h në Kajro dhe vdiq në vitin 1429 h . (1955-2008).

⁵⁷ Dokumentar: Kufoma e shejh Muhamed Amër Abdul-Latif.

Shejh Ismail el-Ensari

Dijetarët e vërtetë janë ata të cilët edhe nëse kanë ndonjë mospajtim për ndonjë çështje fetare, nuk ua humbin meritën dijetarëve të mendimit tjetër, por atyre ua japin pozitën e merituar, ndërsa për çështjet fetare secili prej tyre e tregon mendimin e vet, në bazë të argumenteve sheriatike. Si shembull tipik kemi rastin e shejh Ismail el-Ensarit⁵⁸ i cili nuk pajtohej me shejh Albanin në një çështje fikhore, andaj bëri një studim dhe e botoi në revistën "el-Menhel". Këtë e bëri me një edukatë të lartë duke mos e lënduar personalitetin e shejh Albanit. Këtu po e citoj një pjesë të shkrimit të tij:

Dijetari i madh, muhadithi Nasirudin Albani ka shkruar një shkrim me vlerë rreth edukatës së martesës, ka bërë përzgjedhje të haditheve Pejgamberike me një precizitet të lartë dhe se

⁵⁸ Shejh Ismail bin Muhamed el-Ensari, dijetar i madh në shumë fusha të fesë islame e sidomos në hadith. U lind në vitin 1340 h në Mali dhe vdiq në vitin 1417 h në Rijad të Arabisë Saudite. (1921-1996).

*e kam pëlqyer këtë studim, megjithatë nuk jemi
pajtuar me mendimin e tij në lidhje me...*

Shejh Abdullah el-Karavi

Për respektin e shejh Abdullah el-Karavit që i bënte
motrës së tij, tregon djali i tij duke thënë:

*Babai im kishte vetëm një motër e cila ishte më
e vjetër se ai. Nuk kam parë respekt dhe
mëshirë sikur që kishin ata dy mes veti. Kur
kthehej prej udhëtimit pas mungesës së gjatë, e
përqaftonte motrën shumë dhe që të dytë qanin,
ngase nëna i kishte vdekur dhe motrën e njihte
në vend të nënës...*

Po ashtu kur ishin në haxh, gjatë ngjitjes në
automjete të larta, ajo duhej të ngjitej nëpër disa
shkallë e pastaj në automjet, mirëpo ai nuk pranonte
përveç se ajo të mbështetej në krahët e tij dhe të hipte

në automjet! Kështu disa nuk bëjnë as me nënat e tyre...⁵⁹

Shejh Salih el-Hamudi ⁶⁰

Ishte thirës i flaktë. Njeri i cili për më tepër se një çerek shekulli vizitoi vende të ndryshme të botës për davet. Ishte bamirës i madh, kishte edukatë të lartë. Mijëra njerëz e kishin pranuar Islamin në dorën e tij. Vetëm në udhëtimin e tij të fundit të cilin e kishte disa ditë para se të vdiste e pranuan islamin rreth gjashtëdhjetë persona në një shtet të Afrikës.

Për suksesin të cilin ia dhuroi Allahu i Madhëruar këtij njeriu në fushën e davetit, flasin disa davetxhi të njohur të cilët e njihnin për së afërmi. Ndër ta janë: Sulejman el-Xhubejlan, Halid ed-Dajil dhe Sad el-Burejk. Këta tregojnë:

⁵⁹ Bendër bin Fehd el-Ida, Rruga e reformatorit Imam Abdullah bin Muhamed el-Karavi, f. 213.

⁶⁰ U lind në vitin 1967 dhe vdiq në vitin 2015 në Rijad.

Ky njeri për 25 vite si fqinj, nuk është parë vetëm se i buzëqeshur. Zembrën e kishte të pastër ndaj njerëzve dhe kishte respekt të madh për të dy prindërit e tij, sa që babai i tij pasi e kishte varrosur shejhun kishte thënë për të: O Zot unë dëshmoj se jam i kënaqur me të.⁶¹

⁶¹ Dokumentar: Njeriu i davetit Salih el-Hamudi.

Kapitulli 6

Namazi nafi

Padyshim se besimtari ka nevojë që të ketë adhurim të fshehtë mes tij dhe Allahut të Madhëruar, e sidomos të bëjë namaz gjatë orëve të natës. Ky lloj adhurimi është ushqim për zemrën dhe furnizim për rrugën e gjatë. Është prej veprave më të mira dhe më të vlefshme. I Dërguari i Allahut ﷺ thotë:

Namazi më i vlefshëm pas namazit obligativ, farzit, është namazi i natës. ⁶²

Edhe këtu kam sjell disa raste me synimin që të përfitojmë në këtë pikë, duke e lutur Allahun e Madhëruar që të na i zgjon zemrat tona nga shkujdesi.

⁶² Muslimi, nr. 1163.

Shejh Bin Bazi

Ishte gjë e njohur prej tij që rregullisht zgjohej një orë para namazit të sabahut dhe i falte njëmbëdhjetë rekate me frikërespekt dhe përlulshmëri...⁶³

Shejh Albani

Tregon Muhamed I'd Abbasi për namazin e shejh Albanit duke thënë:

Unë dhe disa vëllezër e falnim namazin e teravive, ndërsa shejh Albani na printe në namaz, duke e zgjatur rreth tri orë. I praktikonte edhe sunetet më të vogla, rukun dhe sexhden i zgjaste, ashtu që në një ruku qëndronte tetë-nëntë minuta. Në mes çdo dy rekateve bënte istigfar dhe tesbih. Njëherë dikush e pyeti për një çështje; (duke qenë në këtë gjendje) i tha atij: Tash është koha e

⁶³ Muhamed el-Hamed, Teraxhum, f. 408.

adhurimit (ibadetit), e koha e diturisë është tjetër herë. ⁶⁴

Shejh Salih el-Husejn

Shejh Muhamed el-Furejh për mësuesin dhe njeriun e afërt të tij shejh Salih el-Husejn⁶⁵ tregon:

Mes namazit të akshamit dhe jacisë falte afër dymbëdhjetë rekate namaz nafile nëse nuk ishte udhëtar. Disa herë e kam parë kështu pranë Qabes. ⁶⁶

Shejh Muhamed bin Salih el-Uthejmin

Tregon Bender el-Abdeli për mësuesin e tij shejh Muhamed bin Salih el-Uthejmin se ai kishte "virdin" (kohë apo orar i caktuar të cilin e kalon në adhurim)

⁶⁴ Abdulaziz es-Sed-han, *El-Imam el-Albani*, f. 89.

⁶⁵ U lind në qytetin Shakra, afër kryeqytetit Rijad, në vitin 1932 dhe vdiq në vitin 2013. Ishte njeri i mençur, mendjemprehtë. Në fund të jetës së tij ishte përgjegjës i dy xhamive të shenjta, pra, i dy Haremeve.

⁶⁶ www.al-jazirah.com, Muhamed el-Furejh, Shkrim mbi biografinë e shejh Salih el-Husejn.

gjatë natës të cilin nuk e linte asnjëherë, në vendbanim apo udhëtim. Duke u falur lutej dhe këtë e bënte ngase Allahu i Madhëruar zbret në pjesën e tretë të natës, dhe pyet: Kush më lutet mua, e t'i përgjigjem atij, kush kërkon falje, e ta fal atë...

Po ashtu namazin e falte me përsosmëri, me frikërespekt e me zemër...⁶⁷

Shejh Hamud et-Tuvejxhri

Shejh Abdulaziz es-Sed-han për shejh Hamud et-Tuvejxhri⁶⁸ thotë:

E kam vërejtur më tepër se një herë dhe jam inforuar se kjo ishte traditë e tij; zbukurimi për namaz duke e veshur xhyben dhe duke u

⁶⁷ Muhamed el-Hanahineh, Pjesë educative nga jeta e shejh Ibn Uthejmin, transmetim i nxënësit të tij Bender el-Abdeli.

⁶⁸ Hamud el-Tuvejxhri është dijetar i njohur dhe autor i dhjetëra librave. U lind në qytetin el-Mexhmea'h të Arabisë Sauditenë vitin 1334 h dhevdiq në vitin 1413 h në Rijad. (1916-1992)

parfymosur, e mos pyet për hershmërinë e tij për namaz. ⁶⁹

Shejh Abdullah el-Gudejan

Shejh Muhamed el-Hudejri për shejh Abdullah el-Gudejan-in ⁷⁰ thotë:

Ishte njeri që falte namaz nate, ashtu siç është traditë e dijetarëve të mëdhenj. Më ka treguar djali i tij se sa herë që zgjohesha për ta falur namazin e vitrit në pjesën e fundit të natës, e shihja dhomën e babait tim (Abdullah el-Gudejan) të ndezur, sepse falej natën. ⁷¹

⁶⁹ Abdulaziz es-Sed-han, Libër biografik nga shejhu Hamud et-Tuvejxhr, f. 19.

⁷⁰ U lind në qytetin ez-Zulfi të Arabisë Saudite në vitin 1345 h dhe vdiq në vitin 1431 h në qytetin e Rijadit (1926-2010)

⁷¹ Ligjëratë për jetën e shejh Abdullah el-Gudejan nga shejh Muhamed el-Hudejri.

